



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 121/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.03.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozime”, me nr. REF-43247-02-01-2018, me objekt “Shërbim i Printimit të Njoftim Detyrimeve të vitit 2018”, me fond limit 6,477,387 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Muhamet Gjollesha”, Zogu i Zi, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
Adresa: Rruga e Kavajës, ish Uzina Mekanike, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.02.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me nr. REF-43247-02-01-2018, me objekt “Shërbim i Printimit të Njofim Detyrimeve të vitit 2018”, me fond limit 6,477,387 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

II.2. Në datën 07.02.2018, operatori ekonomik ankimues “Adel Co” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues nëpërmjet shkresës nr. 16232/1 prot., datë 13.02.2018, duke e pranuar pjesërisht atë.

II.4.Në datën 20.02.2018 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon: “[...]1. Ne kapacitetin ekonomik dhe financiar, ne piken 2.2.C percaktohet që operatoret ekonomike duhet të paraqesin ”Vërtetim nga autoritetet përkatëse që nuk ka debi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ”.

Nga leximi me kujdes dhe interpretimi i legjislacionit të prokurimit publik, u perpoqem të justifikojmë se mbi çfarë baze ligjore është percaktuar ky kriter. Ne nenin 46 të Ligjit ”Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, percaktohet që:(...citim.)

Sic edhe evidentohet nga baza ligjore e mesiperme, ne asnjë prej pikave nuk percaktohet që autoritetet kontraktore mund të kërkojnë të tilla vërtetime. Pra, legjislacioni për prokurimin publik, i ka dhënë të drejtën autoriteteve kontraktore të hartojnë kriteret e vecanta për kualifikim, me kusht që të jenë brenda fushave të caktuara në vijë të përgjithshme nga ligji. Autoriteti Kontraktor, ka argumentuar këto pike të kriterëve duke i’u referuar një vendimi të autoritetit tuaj, dhe argumenton se ”...citim” Por, vërtetimi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, që është kërkuar nga autoriteti kontraktor për të krijuar bindjen mbi kapacitetet ekonomike dhe financiare të operatoreve ekonomike, është në tejkalim të kompetencave të autoritetit kontraktor. Edhe pse legjislacioni i prokurimit publik i jep të drejtën autoriteteve kontraktore të percaktojnë kriteret që i gjykojnë të nevojshme për të krijuar bindjen mbi realizimin me sukses të kontratës që prokurohet, ky legjislacion nuk i jep kompetencë të pakufizuar mbi kriteret që mund të percaktojnë, por i kufizon duke percaktuar fushat në të cilat duhet kërkuar ky informacion, duke mos renduar pozitën e operatoreve ekonomike. Për më tepër, përveçse e ka percaktuar këto kriter në kundërshtim me kërkesat e ligjit, autoriteti kontraktor e ka lënë tepër evaziv këto kriter, pasi nuk ka percaktuar as vitet për të cilat kërkohet ky vërtetim. Duke mos qenë në qartë në dokumentacionin e kërkuar, ky kriter mund të përbejë shkak për skualifikime arbitare gjatë fazës së vlerësimit të ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur nga operatoret ekonomike. Legjislacioni i prokurimit publik e shpreh që, kriteret të jenë të qarta dhe të mos krijojnë konfuzion, ndaj ky sqarim do bente të mundur përmbushjen e parashikimit ligjor dhe do shmangte paqartësitë. Fakti që Autoriteti Kontraktor është në rolin e institucionit që leshon këto vërtetime, nuk e legjitimon që të kërkojë këto vërtetime, pasi nëse qëllimi i ligjvënësive do të ishte përkrahje ky atehere do të përbejë diskriminim nëse çdo autoritet kontraktor do të kërkonte vërtetime mbi shlyerjen e detyrimeve në fushën e veprimtarisë që kanë të caktuar me ligj. Edhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ”Kontratat e mallrave” dhe në nenin 28 ”Kontratat e shërbimeve”, legjislacioni referon në nenin 46 të ligjit, duke e kufizuar fushën e kriterëve që mund të caktojnë autoritetet kontraktore, në mënyrë që autoritetet kontraktore të hartojnë vetëm kriteret që janë proporcionale me procedurat e prokurimit konkrete. Përsa me sipër, kërkojmë heqjen e këtij kriteri nga dokumentat standarte të tenderit pasi percaktimi i tij është bërë në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

2. Në dokumentat e tenderit, në kapacitetin teknik, pika 1.b percaktohet se ”Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 10 punonjës, për realizimin e kontratës, për periudhën gusht 2017 dhjetor 2017 dhe janar 2018”. Për ta vërtetuar këtë, operatori duhet të paraqesë:

-Vërtetim të lëshuar nga sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj sa më sipër.

-List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e mësipërme, ku të jenë të përfshirë dhe stafi teknik mbështetës.

-Dy nga punonjësit duhet të jenë të çertifikuar me çertifikata HSE për sigurinë në punë ”.

Ne lidhje me periudhën e vërtetimit që leshohet nga administrata tatimore, autoriteti kontraktor e ka pranuar si pike dhe thekson në kthimin e përgjigjes se do të beje modifikimet. Persa i perket pikës së dytë për të cilën jemi ankuar dhe që nuk është pranuar, ankesa jone konsiston në faktin që ky kriter është shumë evaziv dhe njesoj si kriteret me sipër, le hapësirë për interpretime të ndryshme dhe njëkohësisht përben shkak për skualifikime të padrejta të operatoreve ekonomike. Kështu që, AK duhet të sqarojë se çfarë stafi teknik duhet të jetë i përfshirë në listepagesa dhe ku konsiston përfshirja e këtij stafi teknik? Autoriteti Kontraktor, në përgjigjen me ane të shkresës 16232/1 Prot., datë 13.02.2018, argumenton se: ”është e rëndësishme që OE të kenë një staf teknik që ti përgjigjet në kohë rekord çdo problematike që mund të lindë gjatë zbatimit të kontratës”. Nga kjo kuptohet se pse stafi teknik është i rëndësishëm, por nuk ka bërë sqarimet e nevojshme për pretendimet e ngritura nga ana e shoqërisë ”Adel CO”, se çfarë stafi teknik duhet të jetë i përfshirë në listepagesa. Theksojmë se kriteret që janë të paqarta dhe evazive që krijojnë hapësira për interpretime të ndryshme, cenojnë parimin e sigurisë juridike, i cili përveçse mbrohet nga legjislacioni i prokurimit publik, është edhe një parim konstitucional. Ju lutemi për modifikimin e këtij kriteri në përputhje me parashikimet ligjore. Ne lidhje me çertifikatat HSE, për sigurinë në punë, mendojmë që është një kërkesë e tepert dhe në tejkalim të kompetencave që ka autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim. Ne mendojmë se autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter aspak proporcional duke përbërë shkak për kufizimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit konkrete dhe mbi të gjitha në tejkalim të qellimit kryesor që është realizimi me sukses i kontratës. Në kushtet që autoriteti kontraktor ka përcaktuar paraqitjen e çertifikatës ISO 45001 ose 18001 Çertifikatë për Sigurinë në Punë, e cila është një çertifikatë që përfshin ngritjen e një sistemi të plotë në të gjithë kompaninë për sigurinë dhe shëndetin në punë, pra e ka të inkorporuar trajnimin dhe përshtatjen e të gjithë sistemit të punës në përputhje me standartet nderkombetare, nuk është me vend që të kërkojë edhe çertifikata me vete për punonjës specifikë, pasi jo kërkesë është në tejkalim të qellimit të autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kontratës që prokurohet. Autoritetet kontraktore nuk mund të kërkojnë të gjithë dokumentacionin e mundshëm që ekziston në përmbushje të një kriteri, për më tepër kur edhe ISO 45001 ose 18001 dhe çertifikata HSE janë standarte nderkombetare. Pra, kjo kërkesë nuk është proporcionale me fondin limit që prokurohet dhe me natyrën e mallit që prokurohet. Persa me sipër, kërkojmë heqjen e këtij kriteri nga dokumentat standarte të tenderit, pasi parashikimi i tij është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

3. Në dokumentat standarte të tenderit, në mjetet dhe pajisjet parashikohet që operatori ekonomik duhet të ketë: ”Dy (2) makineri shtypi digital me ngjyra, me shpejtësi minimale 50.000 cp/A4 në ditë secila. Kjo duhet të vërtetohet me faturë blerje dhe dokumente zhdoganimi si dhe dokumentacionin teknik të makinerisë ose kontratë qiraje (e noterizuar) të vlefshme deri në përfundim të afatit të realizimit të kontratës ”. Ky kriter është në kundërshtim me legjislacionin e

prokurimit publik dhe kufizon pjesemarrjen ne procedurat e prokurimit publik. Se pari, theksojme se referuar sasise dhe grafikut te levrimit, pothuajse gjysma e mallit eshte shtyp me ngjyra dhe gjysma shtyp bardhezi, nderkohe qe AK ka parashikuar detyrimisht 2 makineri printimi dixhitale me ngjyra, duke kufizuar ne kete menyre pjesemarrjen ne kete procedure prokurimi, nderkohe qe mund te kishte percaktuar edhe makineri dixhitale me ngjyra, edhe makineri dixhitale printimi bardhezi. Se dyti, ky kriter eshte diskriminues dhe kufizon konkurencen ne kete procedure. Percaktimi ne menyre strikte i numrit te makinerive dixhitale gjithashtu edhe i shpejtesise minimale te printimit kufizon ne menyre te hapur konkurencen ne kete procedure prokurimi. Ajo qe mund te percaktohet nga autoriteti kontraktor eshte vetem shpejtesia minimale e kerkuar, dhe duhet te lihet ne dore te operatoreve ekonomike qe te vertetojne se me sa makineri mund ta vertetojne kete kriter. Nje operator ekonomik mund te kete edhe nje makineri me dyfishin e shpejtesise se kerkuar per kete proces, ose mund te kete me shume se dy makineri dhe mund ta tejkaloje kete proces. Pra, persa me siper, ju lutemi modifikimin e ketij kriteri duke lene mundesi operatoreve ekonomike qe te vertetojne me disa menyra qe e arrijne kapacitetin e kerkuar nga AK ne DST. Percaktimi i bere nga AK ne kete kriter kufizon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi.

Se treti, ne lidhje me kerkesen e AK per te paraqitur dhe fature blerje dhe fature zhdoganimi, ju bejme me dije se ky kriter e rendon poziten e operatoreve ekonomike potenciale per te marre pjese ne kete procedure prokurimi dhe eshte ne kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, pasi i kufizon operoret ekonomike potenciale per te marre pjese ne kete procedure prokurimi, pasi ne cdo rast ka percaktuar qe disponimi i ketyre makinerive te vertetohet edhe me ane te faturave te blerjes edhe me dokumentat e zhdoganimit. Referuar legjislacionit te fushes ekonomike, marredheniet tregtare te subjekteve shqiptare mund te jene brenda ose jashte vendit. Pra nje subjekt, ne rastin tone nje subjekt juridik mund te bleje mallra dhe sherbime si brenda ashtu edhe jashte vendit. Ne rastin e blerjeve te mallrave brenda vendit, si dokument qe sherben per blerjen eshte fatura tatimore e blerjes. Ne rastin e blerjes se mallrave jashte Shqiperise, deshmia e blerjes se ketij malli eshte deklarata e zhdoganimit te mallit. Ne kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, duke qene se nuk le mundesine qe operoret ekonomike te provojne me ane fatures tatimore te blerjes ose te deklaratave te zhdoganimit disponimin e nje malli, eshte ne kundërshtim me frymen qe kerkon te percjelle legjislacioni i prokurimit publik. Pra, kerkojme qe autoriteti kontraktor ta modifikoje kete parashikim duke kerkuar qe operoret ekonomike, ne permbushje te ketij kriteri te paraqesin ose faturen tatimore te blerjes ose deklaraten e zhdoganimit te mallit, ne varesi te formes qe eshte fituar pronesia e mallit. Theksojme se ky kriter eshte ne kundërshtim te hapur me legjislacionin e prokurimit publik dhe cenon nje nga parimet kryesore te ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, konkretisht cenon barazine midis operatoreve ekonomike, duke u bere shkak keshtu per uljen e konkurences ne pjesemarrjen e procedurave te prokurimit publik, luhatjen e ekonomise se tregut, per pasoje ulet pjesemarrja ne keto procedura prokurimi, ulet konkurenca dhe con ne keqperdorim te fondeve publike. Pra, rendesia e hartimit te kriterëve per kualifikim eshte shume e madhe pasi kriteret e hartuara ne kundërshtim me ligjin cojne ne cenimin e interesit publik qe mbrohet edhe ne nivel konstitucional . Persa i perket argumentimit qe ka bere AK per keto makineri, me pretendimin se dy makineri jane te nevojshme jo vetem per permbushjen e qellimit,

ju bejme me dije se nuk kemi ngitur pretendime mbi shpejtesine e kerkuar, por mbi kufizimin e numrit te makinerive, pasi per autoritetin kontraktor duhet te jete e rendesishme shpejtesia dhe realizimi ne kohe i sherbimit te kerkuar, dhe jo numri i makinerive. Persa me siper, ju lutemi modifikimin e ketij kriteri, pasi percaktimi i tij eshte ne kundersizim me legjislacionin e prokurimit publik.

4. Ne dokumentat standarte te tenderit, ne mjetet dhe pajisjet teknike qe duhet te kene operatoret ekonomike eshte percaktuar qe "Të ketë 2 (dy) makineri zarfimi (insertimi) automatik, me shpejtësi minimale 40.000 zarfa/ditë secila. Të vërtetohet me faturë blerje dhe dokumenta zhdoganimi si dhe dokumentacionin teknik të makinerisë ose kontratë qiraje (e noterizuar) të fletshme deri në përfundim të afatit të realizimit të kontratës". Duke patur parasysh sasine e mallrave qe prokurohet, dhe kohen ne te cilen kerkohet realizimi i ketij malli, mendojme se ky mall realizohet me se miri dhe ne nje kohe edhe me te shpejte se koha e levrimit e percaktuar nga ju edhe duke disponuar nje makineri. Pra, ne mendojme qe ky kriter nuk eshte proporcional me objektin e kontrates qe prokurohet, pasi edhe nje makineri zarfimi, me kapacitetin qe ka e realizon me se miri zarfimin e sasise se kerkuar ne specifkimet teknike. Ajo qe mund te percaktohet nga autoriteti juaj kontraktor eshte vetem shpejtesia minimale e kerkuar per makinerine, dhe duhet te lihet ne dore te operatoreve ekonomike qe te vertetojne se me sa makineri mund ta vertetojne kete kriter. Nje operator ekonomik mund te kete edhe nje makineri me dyfishin e shpejtesise se kerkuar per kete proces, ose mund te kete me shume se dy makineri dhe mund ta tejkalojte kete proces. Pra, persa me siper, ju lutemi modifikimin e ketij kriteri duke lene mundesi operatoreve ekonomike qe te vertetojne me disa menyra qe e arrijne kapacitetin e kerkuar nga ju ne DST. Percaktimi i bere nga ana juaj ne kete kriter kufizon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi. Ne lidhje me dokumentacionin qe duhet te paraqese operatori ekonomik per te vertetuar disponimin apo posedimin e makinerise se kerkuar, mbajme te njejtin qendrim si ne kriterin e mesiperme dhe kerkojme modifikimin e DST edhe per kete pike. Pra persa me siper, ky percaktim duhet te modifikohet dhe te lejohet vertetimi me ane te fatures se TVSH ose deklarates se zhdoganimit. Persa me siper, ju lutemi modifikimin e ketij kriteri ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

5. Ne dokumentat standarte te tenderit, ne dokumentat e vecanta per kualifikim, ne piken f) percaktohet edhe procesi i testimi "Operatori ekonomik do ti nënshtrohet një testi me prodhimin e 2000 copë Njoftim Detyrime në prezencën e një komisioni i cili do të verifikojë dhe praninë në vend të pajisjeve të kërkua më sipër". Ky kriter i vendosur nga autoriteti kontraktor eshte ne kundersizim me legjislacionin e prokurimit publik, e mbeshtetur kjo edhe me praktiken e institucionit tuaj per procedura prokurimi te ngjashme me proceduren konkrete te prokurimit. Ne kushtet qe autoriteti kontraktor per kete procedure prokurimi ka percaktuar kriterin qe " Në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, OE duhet të paraqesë minimalisht 50 modele të "Njoftim Detyrimeve" me Zarf, me të dhëna variabël ku informacioni variabël mund të jetë vetëm për ilustrim, ndërkohë karakteristikat teknike duhet të jenë të njëjtat me ato të kërkua në specifkime dhe në modelin e paraqitur", e gjejme te pavend dhe aspak proporcionale me objektin qe prokurohet qe autoriteti kontraktor: per te krijuar bindjen qe operoret ekonomike kane kapacitet per te realizuar me sukses objektin qe prokurohet, kerkon edhe mostra te mallit, edhe testimin ne vend per prodhimin e fileve, njekohesisht edhe nje liste te gjate dhe te

pajustificueshme makinerish. Keto percaktime te bera ne DST per kriteret e vecanta per kualifikim jane ne kundershtrim me cdo baze ligjore dhe aspak proporcionale me qellimin primar qe duhet te kete nje autoritet kontraktor gjate nje procedure prokurimi. Me konkretisht, ne nje procedure analoge me kete, e shqyrtuar nga institucioni juaj ku ishte percaktuar i njejt kriter kualifikimi, ky kriter eshte hequr dhe eshte argumentuar me se miri qendrimi qe duhet te mbajne autoritetet kontraktore, me ane te vendimit nr. 318/2017 Prot, Date 17.05.2017, ku KPP shprehet se(...citim) Referuar ketij interpretimi tuaj mbi thujse per te njejt kriter, mendojme se kjo kerkese nuk eshte proporcionale me objektin e prokurimit dhe me legjislacionin e prokurimit publik. Persa me siper, kerkojme heqjen e ketij kriteri nga DST. Persa me siper, kriteret e vendosura nga AK jane ne kundershtrim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, per pasoje kerkojme heqjen dhe modifikimin e tyre nga DST. Ju bejme me dije se qellimi qe parashikon Ligjvnesi per hartimin e kriterëve te pergjithshme apo te vecanta te kualifikimit nga ana e autoriteteve kontraktore, nuk eshte te krijoje ngerce apo hapesira apo pengesa per operatoret ekonomike. Ne fakt ai eshte diametralisht i kundert: Qellimi i hartimit te kriterëve te vecanta te kualifikimit eshte qe Autoriteti kontraktor te krijoje bindjen se nje operator ekonomik i disponon kapacitetet ligjore, financiare apo teknike per realizimin e procedures se prokurimit. Per sa me siper kerkojme modifikimin e DST ne lidhje me kriteret e mesiperme, pasi percaktimi i tyre ne DST eshte ne kundeshtrim me ligjin “Per prokurimin Publik”..[...]”

II.5.Në datën 27.02.2018, nëpërmjet shkresës me nr.19296/1 prot., datë 23.02.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Adel Co” sh.p.k.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin “1. Ne kapacitetin ekonomik dhe financiar, ne piken 2.2.C percaktohet qe operatoret ekonomike duhet te paraqesin ”Vërtetim nga autoritetet përkatëse që nuk ka debi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ”.

Nga leximi me kujdes dhe interpretimi i legjislacionit te prokurimit publik, u perpoqem te justifikojme se mbi cfare baze ligjore eshte percaktuar ky kriter. Ne nenin 46 te Ligjit ”Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, percaktohet qe:(...citim.)

Sic edhe evidentohet nga baza ligjore e mesiperme, ne asnje prej pikave nuk percaktohet qe autoritetet kontraktore mund te kerkojne te tilla vertetime. Pra, legjislacioni per prokurimin publik, i ka dhene te drejten autoriteteve kontraktore te hartojne kriteret e vecanta per kualifikim, me kusht qe te jene brenda fushave te caktuara ne vija te pergjithshme nga ligji. Autoriteti

Kontraktor, ka argumentuar kete pike te kriterëve duke i'u referuar nje vendimi te autoritetit tuaj, dhe argumenton se "...citim" Por, vertetimi per pagesen e taksave dhe tarifave vendore, qe eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor per te krijuar bindjen mbi kapacitetet ekonomike dhe financiare te operatoreve ekonomike, eshte ne tejkalim te kompetencave te autoritetit kontraktor. Edhe pse legjislacioni i prokurimit publik i jep te drejten autoriteteve kontraktore te percaktojne kriteret qe i gjykojne te nevojshme per te krijuar bindjen mbi realizimin me sukses te kontrates qe prokurohet, ky legjislacion nuk i jep kompetenca te pakufizuara mbi kriteret qe mund te percaktojne, por i kufizon duke percaktuar fushat ne te cilat duhet kerkuar ky informacion, duke mos renduar poziten e operatoreve ekonomike. Per me teper, pervecse e ka percaktuar kete kriter ne kundërshtim me kerkesat e ligjit, autoriteti kontraktor e ka lene teper evaziv kete kriter, pasi nuk ka percaktuar as vitet per te cilat kekrohet ky vertetim. Duke mos qene ne qarte ne dokumentacionin e kerkuar, ky kriter mund te perbeje shkak per skualifikime arbitare gjate fazes se vleresimit te ofertave dhe dokumentacionit te paraqitur nga operatorët ekonomike. Legjislacioni i prokurimit publik e shpreh qe, kriteret te jene te qarta dhe te mos krijojne konfuzion, ndaj ky sqarim do bente te mundur permbushjen e parashikimit ligjor dhe do shmangte paqartësite. Fakti qe Autoriteti Kontraktor eshte ne rolin e institucionit qe leshon keto vertetime, nuk e legjitimon qe te kerkoje keto vertetime, pasi nese qellimi i ligjvenesit do te ishte pikerisht ky atehere do te perbente diskriminim nese cdo autoritet kontraktor do te kerkonte vertetime mbi shlyerjen e detyrimeve ne fushen e veprimtarise qe kane te caktuar me ligj. Edhe ne nenin 27 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar "Kontratat e mallrave" dhe ne nenin 28 "Kontratat e shërbimeve", legjislacioni referon ne nenin 46 te ligjit, duke e kufizuar fushen e kriterëve qe mund te caktojne autoritetet kontraktore, ne menyre qe autoritetet kontraktore te hartojne vetem kriterë qe jane proporcionale me procedurat e prokurimit konkrete. Persa me siper, kerkojme heqien e ketij kriteri nga dokumentat standarte te tenderit pasi percaktimi i tij eshte bere ne kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik." Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 7, pika 2.2.c, "Për kapacitetin ekonomik dhe financiar", nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

"c) Vërtetim nga autoritetet përkatëse që nuk ka debi për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB."

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, gërma "c" e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë,*

të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”.

III.1.3. Në nenin 26 pika 2 “Kontratat për punë publike” të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.1.4. Në nenin 26, pika 7 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

III.1.5. Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se: *Në taksat vendore përfshihen: 1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël. 2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore. 3. Taksa e fjetjes në hotel. 4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. 5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. 6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve. 7. Taksa për zënieën e hapësirave publike. 8. Taksa e tabelës. 9. Taksa të përkohshme. Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se: “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor

mbi dorëzimin e një dokumenti, përmes të cilës vërtetohet se, subjekti të ketë paguar taksat dhe tarifatat lokale nuk është një kriter diskriminues dhe është në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës. Është në të drejtën e autoriteteve kontraktore të vendosin ato kritere ligjore të cilat i paraqesin një panoramë të qartë këtij të fundit mbi kapacitetin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. E rëndësishme është që kriteret të mos jenë diskriminuese dhe të ofrojnë një trajtim të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe të jenë në proporcion me natyrën e kontratës. Pra sa më sipër, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të përcaktojë kritere që referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, lidhur me vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve mbi taksat dhe tarifatat vendore, gjithmonë kur ky informacion është i mundur. Ndërsa lidhur me pretendimin për mospërcaktimin e viteve për të cilët kërkohet ky vërtetim, KPP konstaton se, në dokumentat e tenderit, shtojca 7, pika 2.2.c, “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e të gjitha detyrimeve mbi taksat dhe tarifatat vendore si dhe në rast bashkimi të operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. KPP gjykon se mënyra e formulimit të kriterit nga ana e autoritetit kontraktor është e qartë dhe në përputhje me nenin 28, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik, gjen me vend të theksojë, se në bazë të legjislacionit për prokurimin publik, autoriteti kontraktor i rezervon vetes të drejtën e verifikimit të dokumentacionit nëse do të ketë dyshime mbi një operator ekonomik, nëse ky i fundit ka detyrime pranë ndonjë institucioni të pushtetit vendor të cfarolloj natyre. Për më tepër, KPP gjykon se në rast se një institucion i pushtetit vendor, lëshon një dokument që vërteton në mënyrë kumulative që operatori ekonomik i cili kryen aktivitet tregtar brenda juridiksionit të tij, ka shlyer të gjitha detyrimet mbi taksa dhe tarifatat vendore, atëherë nuk është e nevojshme që vërtetimi të lëshohet e përcaktuar me vite apo periudha.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “2. *Ne dokumentat e tenderit, ne kapacitetin teknik, pika 1.b percaktohet se ”Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 10 punonjës, për realizimin e kontratës, për periudhën gusht 2017 dhjetor 2017 dhe janar 2018”. Për ta vërtetuar këtë, operatori duhet të paraqesë:*

-Vërtetim të lëshuar nga sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj sa më sipër.

-List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e mësipërme, ku të jenë të përfshirë dhe stafi teknik mbështetës.

-Dy nga punonjësit duhet të jenë të çertifikuar me çertifikata HSE për sigurinë në punë ”.

Ne lidhje me periudhën e vërtetimit që lëshohet nga administrata tatimore, autoriteti kontraktor e ka pranuar si pike dhe thekson në kthimin e përgjigjes se do të bëjë modifikimet. Përsa i përket pikës së dytë për të cilën jemi ankuar dhe që nuk është pranuar, ankesa jone konsiston në faktin që ky kriter është shumë evaziv dhe njesoj si kriteret me sipër, le hapësirë për interpretime të

ndryshme dhe njekohesisht perben shkak per skualifikime te padrejta te operatoreve ekonomike. Keshtu qe, AK duhet te sqaroje se cfare stafi teknik duhet te jete i perfshire ne listepagesa dhe ku konsiston perfshirja e ketij stafi teknik? Autoriteti Kontraktor, ne pergjigjen me ane te shkreses 16232/1 Prot., date 13.02.2018, argumenton se: "eshte e rendesishme qe OE te kene nje staf teknik qe ti pergjigjet ne kohe rekord cdo problematike qe mund te linde gjate zbatimit te kontrates". Nga kjo kuptohet se pse stafi teknik eshte i rendesishem, por nuk ka bere sqarimet e nevojshme per pretendimet e ngritura nga ana e shoqerise "Adel CO", se cfare stafi teknik duhet te jete i perfshire ne listepagesa. Theksojme se kriteret qe jane te paqarta dhe evazive qe krijojne hapersira per interpretime te ndryshme, cenojne parimin e sigurise juridike, i cili pervecse mbrohet nga legjislacioni i prokurimit publik, eshte edhe nje parim konstitucional. Ju lutemi per modifikimin e ketij kriteri ne perputhje me parashikimet ligjore. Ne lidhje me certifikatat HSE, per sigurine ne pune, mendojme qe eshte nje kerkese e tepert dhe ne tejkalim te kompetencave qe ka autoriteti kontraktor ne hartimin e kriterëve te vecanta per kualifikim. Ne mendojme se autoriteti kontraktor ka percaktuar nje kriter aspak proporcional duke perbere shkak per kufizimin e pjesemarrjen ne proceduren e prokurimit konkrete dhe mbi te gjitha ne tejkalim te qellimit kryesor qe eshte realizimi me sukses i kontrates. Ne kushtet qe autoriteti kontraktor ka percaktuar paraqitjen e certifikates ISO 45001 ose 18001 Certifikatë për Sigurinë në Punë, e cila eshte nje certifikate qe perfshin ngritjen e nje sistemi te plote ne te gjithe kompanine per sigurine dhe shendetit ne pune, pra e ka te inkorporuar trajnimin dhe pershtatjen e te gjithe sistemit te punes ne perputhje me standartet nderkombetare, nuk eshte me vend qe te kerkoje edhe certifikata me vete per punonjes specifike, pasi jo kerkese eshte ne tejkalim te qellimit te autoritetit kontraktor per realizimin me sukses te kontrates qe prokurohet. Autoritetet kontraktore nuk mund te kerkojne te gjithe dokumentacionin e mundshem qe ekziston ne permbushje te nje kriteri, per me teper kur edhe ISO 45001 ose 18001 dhe certifikata HSE jane standarte nderkombetare. Pra, kjo kerkese nuk eshte proporcionale me fondin limit qe prokurohet dhe me natyren e mallit qe prokurohet. Persa me siper, kerkojme heqjen e ketij kriteri nga dokumentat standarte te tenderit, pasi parashikimi i tij eshte ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi. " Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në dokumentat e tenderit, shtojca 7, pika 1.b, "Kapaciteti teknik", nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

"b) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 10 punonjës, për realizimin e kontratës, për periudhën gusht 2017- dhjetor 2017 dhe janar 2018.

Për ta vërtetuar këtë, operatori duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punjonësve për secilin muaj sa më sipër.
- List pagesat e punjonësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e mësipërme, ku të jenë të përfshirë dhe stafi teknik mbështetës.
- Dy nga punjonësit duhet të jenë të certifikuar me certifikata HSE për sigurinë në punë."

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.2.3. Në nenin 28, pika 5, gërma “b” dhe “c” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose. c.dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*

III.2.4. Në pikën 2 të nenit 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.2.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Në rastin konkret, kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor ka të bëjë me disponimin e 10 punonjësve për realizimin e kontratës pa përcaktuar ndonjë specifikë të vecantë lidhur me to. KPP gjykon se përcaktimet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara përcaktojnë qartë se është në diskrecion të autoritetit kontraktor të përcaktoj kriteret e kualifikimit si dhe dokumentacionin provues, për sa kohë këto kritere janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Në rastin konkret, është në diskrecion të autoritetit kontraktor të përcaktojë në kriter nëse është e mjaftueshme të vërtetohet thjesht disponimi i numrit përkatës të punonjësve, apo të vendosë ndonjë kufizim duke përcaktuar kualifikim, eksperiencë, profesion etj. KPP gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor ky kriter është hartuar qartë duke përcaktuar numrin e nevojshëm dhe dokumentin për të provuar përmbushjen e këtij kriteri, që është me anë të vërtetimit të lëshuar nga sigurimet shoqërore ose administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj sa më sipër, si dhe list pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e mësipërme, ku të jenë të përfshirë dhe stafi teknik mbështetës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.6. Ndërsa lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kërkesën e autoritetit kontraktor “*Dy nga punjonësit duhet të jenë të çertifikuar me çertifikata HSE për sigurinë në punë*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.7. Në nenin 46 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë...[...]” Ndërsa në nenin 46 pika 3 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “[...] Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik [...]”.

III.2.8. Në nenin 30 të Vendimit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.2.9. KPP thekson, se autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Çertifikatave të trajnimit HSE, është në përpjesëtim me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Ndaj KPP gjykon se në përgjigje të testit të proporcionalitetit, kërkimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e çertifikatës HSE, është një kërkesë në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e procedurës dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme. Duke i dhënë në këtë mënyrë garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se “[...]Ne dokumentat standarte te tenderit, ne mjetet dhe pajisjet parashikohet qe operatori ekonomik duhet te kete: ”Dy (2) makineri shtypi digital me ngjyra, me shpejtësi minimale 50.000 cp/A4 në ditë secila. Kjo duhet të vërtetohet me faturë blerje dhe dokumente zhdoganimi si dhe dokumentacionin teknik të makinerisë ose kontratë

qiraje (e noterizuar) të vlefshme deri në përfundim të afatit të realizimit të kontratës ”. Ky kriter është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik dhe kufizon pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik. Se pari, theksojmë se referuar sasise dhe grafikut të levrimit, pothuajse gjysma e mallit është shtyp me ngjyra dhe gjysma shtyp bardhezi, nderkohe që AK ka parashikuar detyrimisht 2 makineri printimi dixhitale me ngjyra, duke kufizuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi, nderkohe që mund të kishte përcaktuar edhe makineri dixhitale me ngjyra, edhe makineri dixhitale printimi bardhezi. Se dyti, ky kriter është diskriminues dhe kufizon konkurrencën në këtë procedurë. Përcaktimi në mënyrë strikte i numrit të makinerive dixhitale gjithashtu edhe i shpejtesisë minimale të printimit kufizon në mënyrë të hapur konkurrencën në këtë procedurë prokurimi. Ajo që mund të përcaktohet nga autoriteti kontraktor është vetëm shpejtesia minimale e kërkuar, dhe duhet të lihet në dorë të operatorëve ekonomikë që të vërtetojnë se me sa makineri mund ta vërtetojnë këtë kriter. Një operator ekonomik mund të ketë edhe një makineri me dyfishin e shpejtesisë së kërkuar për këtë proces, ose mund të ketë me shumë se dy makineri dhe mund ta tejkalojë këtë proces. Pra, përsa me siper, ju lutemi modifikimin e këtij kriteri duke lënë mundësi operatorëve ekonomikë që të vërtetojnë me disa mënyra që e arrijnë kapacitetin e kërkuar nga AK në DST. Përcaktimi i bërë nga AK në këtë kriter kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi.

4. Në dokumentat standarte të tenderit, në mjetet dhe pajisjet teknike që duhet të kenë operatorët ekonomikë është përcaktuar që ”Të ketë 2 (dy) makineri zarfimi (insertimi) automatik, me shpejtësi minimale 40.000 zarfa/ditë secila. Të vërtetohet me faturë blerje dhe dokumenta zhdoganimit si dhe dokumentacionin teknik të makinerisë ose kontratë qiraje (e noterizuar) të vlefshme deri në përfundim të afatit të realizimit të kontratës”. Duke patur parasysh sasinë e mallrave që prokurohet, dhe kohën në të cilën kërkohet realizimi i këtij malli, mendojmë se ky mall realizohet me së miri dhe në një kohë edhe me të shpejtë se koha e levrimit e përcaktuar nga ju edhe duke disponuar një makineri. Pra, ne mendojmë që ky kriter nuk është proporcional me objektin e kontratës që prokurohet, pasi edhe një makineri zarfimi, me kapacitetin që ka e realizon me së miri zarfimin e sasisë së kërkuar në specifikimet teknike. Ajo që mund të përcaktohet nga autoriteti juaj kontraktor është vetëm shpejtesia minimale e kërkuar për makinerinë, dhe duhet të lihet në dorë të operatorëve ekonomikë që të vërtetojnë se me sa makineri mund ta vërtetojnë këtë kriter. Një operator ekonomik mund të ketë edhe një makineri me dyfishin e shpejtesisë së kërkuar për këtë proces, ose mund të ketë me shumë se dy makineri dhe mund ta tejkalojë këtë proces. Pra, përsa me siper, ju lutemi modifikimin e këtij kriteri duke lënë mundësi operatorëve ekonomikë që të vërtetojnë me disa mënyra që e arrijnë kapacitetin e kërkuar nga ju në DST. Përcaktimi i bërë nga ana juaj në këtë kriter kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Në lidhje me dokumentacionin që duhet të paraqesë operatori ekonomik për të vërtetuar disponimin apo posedimin e makinerisë së kërkuar, mbajmë të njëjtin qëndrim si në kriterin e mesipër dhe kërkojmë modifikimin e DST edhe për këtë pikë. Pra përsa me siper, ky përcaktim duhet të modifikohet dhe të lejohet vërtetimi me anë të fatures së TVSH ose deklarates së zhdoganimit. Përsa me siper, ju lutemi modifikimin e këtij kriteri në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 7, pikat 1.c.1 dhe 1.c.2, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

“1. Dy (2) makineri shtypi digital me ngjyra, me shpejtësi minimale 50.000 cp/ A4 në ditë secila. Kjo duhet të vërtetohet me faturë blerje dhe dokumenta zhdoganimi si dhe dokumentacionin teknik të makinerisë ose kontratë qiraje (e noterizuar) të vlefshme deri në përfundim të afatit të realizimit të kontratës.

2. Të ketë 2 (dy) makineri zarfimi (insertimi) automatik, me shpejtësi minimale 40.000 zarfa/ditë secila. -Të vërtetohet me faturë blerje dhe dokumenta zhdoganimi si dhe dokumentacionin teknik të makinerisë ose kontratë qiraje (e noterizuar) të vlefshme deri në përfundim të afatit të realizimit të kontratës.”

III.3.2. Gjithashtu në dokumentat e tenderit, shtojca 8, “Specifikime teknike”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Nr	Artikulli	Karakteristika teknike	Njësia Matjes	Sasia
1	Prodhim fletë njoftim detyrimi Zarfa dhe zarfim	Zarf DL me dritare për zarfim automatik me logo bardhë e zi + mesatarisht 2.2 fletë të printuara me të dhëna variable para mbrapa, nga njëri krah me ngjyra+zarfim. Fleteve i duhet vendosur nga një barcode unik në mënyrë që sistemi i zarfimit të bëjë ndarjen e fletëve në çdo zarf. Çdo zarf do të ketë sasi të ndryshme fletësh. Sistemi i prodhimit të OE duhet të jetë në gjëndje ta bëjë vetë ndarjen e fletëve për çdo zarf.	Set	83.000
2	Prodhim fletë njoftim detyrimi	Printimi nga 2 krahët me të dhëna variable bardhë e zi (mesatarisht 2.2 faqe * 83.000 nr.subjecte * 2 kopje njoftim detyrimi)	Faqe	365,200

III.3.3. Në dokumentat e tenderit, shtojca 10, “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: *”Afatet e ekzekutimit: Për shërbimin e printimit dhe zarfimit, lëvrimi duhet të përfundojë 2 ditë nga dhënia e fileve për print.”*

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën*

dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përplotësim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në rastin konkret është kërkuar një numër minimal (2) makineri shtypi digital me ngjyra, me shpejtësi minimale 50.000 cp/A4 në ditë secila, dhe (2) makineri zarfimi (insertimi) automatik, me shpejtësi minimale 40.000 zarfa/ditë secila, të cilat autoriteti kontraktor i gjykon të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, por referuar edhe sasisë dhe grafikut të lëvrimin të mallit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor KPP gjykon se nuk është e nevojshme kërkesa që vetëm 2 makineri të ketë kapacitet me shpejtësi min. 50.000 cp/A4 secila në ditë, si dhe 2 makineri zarfimi (insertimi) automatik, me shpejtësi minimale 40.000 zarfa/ditë secila, pasi operatorët ekonomikë mund ta plotësojnë këtë minimum shpejtësie me më shumë se 2 makineri ose dhe me vetëm me një makineri me kapacitet më të lartë. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës me qëllim përmbushjen me 1 ose më shumë makineri të shpejtësisë minimale. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: 2. *Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Përsa i përket dokumentacionit konkret për të vërtetuar disponueshmërinë e makinerive autoriteti kontraktor nuk duhet të kufizohet duke kërkuar të dyja dokumentet “faturë blerje dhe dokumenta zhdoganimi”, pasi këto makineri mund të blihen edhe në tregun vëndas, dhe në raste të tilla, asnjë blerës nuk ka detyrim për tu pajisur me dokumentacion doganor. Për këtë arsye KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikoj kriterin duke përduror lidhëzën “ose”, në mënyrë që të ketë mundësi vërtetimi për disponimin e makinerive të kërkuara, si operatorët që furnizohen me pajisje të tilla jashtë vendit dhe ata që furnizohen brenda vendit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës me argumentin se “5. Ne dokumentat standarte te tenderit, ne dokumentat e vecanta per kualifikim, ne piken f) percaktohet edhe procesi i testimit ”Operatori ekonomik do ti nënshtrohet një testi me prodhimin e 2000 copë Njoftim Detyrime në prezencën e një komisioni i cili do të verifikojë dhe praninë në vend të pajisjeve të kërkuara më sipër”. Ky kriter i vendosur nga autoriteti kontraktor është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, e mbështetur kjo edhe me praktiken e institucionit tuaj per procedura prokurimi te ngjashme me proceduren konkrete te prokurimit. Ne kushtet qe autoriteti kontraktor per kete procedure prokurimi ka percaktuar kriterin qe ” Në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, OE duhet të paraqesë minimalisht 50 modele të ”Njoftim Detyrimeve” me Zarf, me të dhëna variabël ku informacioni variabël mund të jetë vetëm për ilustrim, ndërkohë karakteristikat teknike duhet të jenë të njëjtat me ato të kërkuara në specifikime dhe në modelin e paraqitur”, e gjejme te pavend dhe aspak proporcionale me objektin qe prokurohet qe autoriteti kontraktor: per te krijuar bindjen qe operatoret ekonomike kane kapacitet per te realizuar me sukses objektin qe prokurohet, kerkon edhe mostra te mallit, edhe testimin ne vend per prodhimin e fileve, njekohesisht edhe nje liste te gjate dhe te pajustifikueshme makinerish. Keto percaktime te bera ne DST per kriteret e vecanta per kualifikim jane ne kundërshtim me cdo baze ligjore dhe aspak proporcionale me qellimin primar qe duhet te kete nje autoritet kontraktor gjate nje procedure prokurimi.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 7, pika 1.f, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar: “Operatori ekonomik do ti nënshtrohet një testi me prodhimin e 2.000 copë Njoftim Detyrime në prezencën e një komisioni i cili do të verifikojë dhe praninë në vend të pajisjeve të kërkuara më sipër.”

III.4.2. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]”

III.4.3. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.4.4. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Synimi i autoritetit kontraktor është shprehur në disa drejtime si në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi në të cilën ka parashikuar mbi cilësinë dhe specifikimet teknike të produktit final, në të cilën ka parashikuar kohëzgjatjen e kryerjes së shërbimit nga momenti i marrjes së porosisë duke lënë si periudhë kohore 2 ditë të printimit të sasisë së porositur. KPP konstaton se për përmbushjen e synimit të këtij autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik (makineri, staf etj) si edhe kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi kryerjen e një testi prej 2000 copë Njoftim Detyrime, nuk është në proporcion me natyrën e procedurës së prokurimit dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Gjithashtu, KPP gjykon se është në të drejtë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të kryejë verifikime të nevojshme në kuadër të procesit të vlerësimit të ofertave, në zbatim të nenit 66 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohet se *“Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.”*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik „Adel Co” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me nr. REF-43247-02-01-2018, me objekt “*Shërbim i Printimit të Njoftim Detyrimeve të vitit 2018*”, me fond limit 6,477,387 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Adel Co” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 294 Protokolli, Datë 20.02.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha

